

VENDIM
Nr. 234, datë 11.5.2000

**PËR KRITERET DHE RREGULLAT E MARRJES SË MOSTRAVE DHE TË VLERËSIMIT
TË PLEHRAVE KIMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 dhe 10, të ligjit nr.8531, datë 23.9.1999, "Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi i plehrave kimike bëhet në bazë të analizimit në laborator të mostrës zyrtare, ku përcaktohen të gjithë ushqyesit parësorë (N, P₂O₅, K₂O), si dhe elemente të tjera, përfshirë edhe mikroelementet, të garantuar dhe të deklaruar në etiketë ose në fletën shoqëruese të plehut.

2. Çdo pleh që prodhohet, përziehet (përgatitja e plehrave të përzierë apo të kombinuar) apo tregtohet, duhet të ketë etiketën ose fletën shoqëruese, ku të deklarohen karakteristikat e përgjithshme të tij.

3. Çdo person, fizik apo juridik, që ofron ose tregon plehra kimike, e shoqëron çdo sasi të plehut kimik me raportin e analizave për treguesit e kërkuar, të vërtetuar nga laborator i ngarkuar për këtë qëllim.

4. Përcaktimi nëse një pleh është me mungesa në përmbajtjen e elementeve ushqyese, ose përmban elemente të dëmshme për njeriun, kafshët, mjedisin, do të mbështetet në rezultatet e analizave të mostrës zyrtare.

5. Vlerësimi i plehut kimik të analizuar bëhet në bazë të kufijve të lejuar për çdo element dhe/ose në llogaritjen e vlerës së indeksit të përgjithshëm të plehut.

6. Plehu kimik vlerësohet me mungesë të elementit ushqyes:

a. kur vlera e analizës së çdo ushqyesi është më e ulët se vlera e garantuar dhe deklaruar (në etiketë ose në fletën shoqëruese të plehut).

b. kur vlera e indeksit të përgjithshëm është më e vogël se 97 për qind.

7. Kufijtë e lejuar të përmbajtjes së deklaruar të mikroelementeve (B, Co, Cu, Fe, Mn, Mo, Zn) janë:

a. 0.4 për qind në terma absolute, për një përmbajtje më të lartë se 2 për qind.

b. një e pesta e vlerës së deklaruar për një sasi që nuk i kalon 2 për qind.

8. Mostra zyrtare përfaqëson një sasi plehu deri në 50 tonë. Në çdo rast përgatiten tri mostra, afërsisht në të njëjtën sasi, pakëtohen dhe pajisen secila me etiketën përkatëse.

Mostrat mbyllen dhe vulosen në mënyrë të tillë që hapja e tyre të çojë në prishjen e vulës.

9. Për çdo mostër, inspektori harton fletën e inspektimit, në tri kopje. Një mostër, e cila duhet të peshojë të paktën 0.5 kg dhe jo më shumë se 1 kg, së bashku me një kopje të fletës së inspektimit i jepet personit, fizik ose juridik, zotërues i plehut që kontrollohet. Mostra e tretë, së bashku me një fletë inspektimi mbahet nga inspektori.

10. Marrja e mostrave bëhet në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga Shërbimi i Kontrollit të Plehrave Kimike.

11. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta